

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18, dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 92, paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-569/1 datë 06.02.2025 dhe Konkluzionin ark.nr. 02-737/10, datë 24.02.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, në seancën e 8-të mbajtur më 24.02.2025, miratoj si vijon:

Aktvendim për ndërmarrje të masës – paralajmërim publik

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar, për shkak të shkeljes së kryer të nenit 92, paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), të mënyrës që transmetuesi, në kuadër të shërbimit programor televiziv, më 27 janar 2025, nuk ka transmetuar së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-569/1 datë 06.02.2025, si pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi me Shtojcë nr.1.

2. DETYROHET që SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi ta harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV.

3. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyruar, i paraqitur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia, në bazë të nenit 28 të LSHMAAV, është kompetente për të kryer mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale sipas kërkesës, si dhe të paketave programore të ritransmetuara nga operatorët e rrjetit publik të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të dispozitave nga Ligji në fjalë, lejeve, çertifikatave të dhëna për regjistrim, akteve nënligjore dhe akte të tjera miratuar nga Agjencia.

Në përputhje me nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë kundër botuesi të medias (transmetuesi) ndërmerr masë - paralajmërim publik në rastet kur është kryer cënim ose shkelje e dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me leje dhe akte tjera të Agjencisë.

Në pikën 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës, është përcaktuar se për shkeljet e konstatuara në vitin aktual, për të cilat janë shqiptuar masa edhe në vitin paraprak, Këshilli i Agjencisë sërish do të shqipton masë vërejtje publike sipas afateve të përcaktuara në Udhëzim.

Sipas nenit 92, paragrafi (1) të LSHMAAV, Shoqëritë Tregtare Radiodifuzive që transmetojnë shërbim programor televiziv detyrohen gjatë ditës të transmetojnë së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audio ose audiovizuale maqedonase, ndërsa shërbimi transmetues publik së paku 40%.

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia përmes Sektorit për çështje programore, më 06.02.2025, ka kryer mbikëqyrje të kontrollit programor (monitorim), të shërbimit publik televiziv të SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar, transmetuar më 27 janar 2025, nga ku është konstatuar se transmetuesi pjesërisht ka vepruar në pajtim me Aktvendimin për shqiptimin e masës – vërejtje publike për shkelje të nenit 92, paragrafi (1) dhe paragrafi (3) të LSHMAAV PA1 nr.03-347 datë 26.12.2024, përkatësisht ka mënjanuar shkeljen e kryer të nenit 92, paragrafi (3) të LSHMAAV, por ka vazhduar të kryen shkelje të nenit 92, paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë.

Gjegjësisht, mbikëqyrja ka konstatuar se më 27 janar 2025, shërbimi programor televiziv i Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar ka transmetuar 4 orë 43 minuta dhe 21 sekonda programe të krijuar burimor si vepra audiovizive maqedonase, që është **22,88%** e totalit të programit të transmetuar gjatë ditës që hyn në llogaritje të programit të krijuar burimor (20 orë 38 minuta dhe 28 sekonda). Minimumi ligjor prej 30% për transmetim të programit të krijuar burimor gjatë një dite, në raport me totalin e programit të transmetuar më 27 janar që hyn në llogaritje të programit të krijuar burimor (20:38:28), është 6 orë 11 minuta dhe 32 sekonda. Televizioni TV DUE ka transmetuar për 1 orë 28 minuta dhe 11 sekonda më pak program të krijuar burimor si vepra audiovizive maqedonase.

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-569/1 datë 06.02.2025, si pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi me Shtojcë nr.1.

Në përputhje me nenin 23, paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar, me datë 11.02.2025, dërgoj Shkresë ark.nr.10-569/2 datë 11.02.2025, me të cilën dorëzoj Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-569/1 datë 06.02.2025, që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimi të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzoj deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Shkresa është pranuar në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 12.02.2025. Në afatin e parashikuar SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar, nuk u deklarua për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 24.02.2025 ka shqyrtuar lëndën Raport me shkrim dhe ka konstatuar që SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar t'i shqiptohet masë – vërejtje publike.

Rrjedhimisht, nga sa më sipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 92, paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-569/1 datë 06.02.2025, për konstatim të mos respektimit të dispozitave të LSHMAAV, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e 8-të mbajtur më 24.02.2025, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-737/10 datë 24.02.2025, miratoj Aktvendim me të cilën publikisht paralajmëron SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar dhe detyrohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i paraqitur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24, paragrafët (1) dhe (2) të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër tij transmetuesi ka të drejtë padie për inicimin e kontstit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për fillimin e kontstit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

Bazuar nga sa më sipër u mor aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- 1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-569/1 datë 06.02.2025.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi mund të ngrejë padi për fillimin e kontstit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për fillimin e kontstit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.